



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	248/11
Nr. i sq. / Br. st	
Data: / Datum:	24. 11. 2011
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 5, pika 3, 3.1, 3.5 të nenit 6, 24, 32,35 pika 4, 50 pika 3, 76, 92, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, nr 03/L-025, nenit 12 dhe 17 "e" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03L-040, nenit 41.2 "c" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2011 aprovoi këtë:

## RREGULLORE

### PËR

### MBROJTJEN E MJEDISIT

#### I. Dispozitat e Përgjithshme

##### Neni 1

Me këtë rregullore plotësohet baza juridike për mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal për qytetarët e komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejmë komuna), në mënyrë që të jetë në përputhshmëri me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunës.

##### Neni 2

Kjo rregullore përcakton të drejtat dhe detyrimet e personave fizik dhe juridik për sigurimin e kushteve dhe masave për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit, resurseve natyrore, me qëllim të realizimit të së drejtës së qytetarëve për mjeshtësimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

##### Neni 3

Sipas kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet si vijon:

- "Dëm i mjedisit" do të thotë aktivitetet që kanë potencial të jashtëzakonshëm dhe të dukshëm që ta dëmtojnë mjedisin në mënyrë substanciale, apo të bëjnë një aksident mjedoror.
- "Degradim" ose "Degradim i mjedisit" - degradim substancial i mjedisit (në atë shkallë që ndikon në kualitetin e jetës), nga ndotja, mbeturinat dhe plehrat ose nga përdorimi apo shfrytëzimi i paautorizuar i burimeve natyrore.

## Neni 5

### Komuna është përgjegjëse për këto çështje mjedisore:

- 5.1 Krijimin e standardeve në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, të akteve tjera nënligjore të nxjerra në bazë të ligjit dhe të kësaj rregulloreje në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- 5.2 Mbikëqyrjen e aktiviteteve, përputhshmérinë e aktiviteteve me standardet dhe normat ligjore të operatorëve të cilët veprojnë në territorin e komunës;
- 4.3 Aprovimin e planeve dhe aktiviteteve në fushën e mbrojtjes së mjedisit për territorin e komunës;
- 5.4 Hartimin e masave të arsyeshme për mbrojtjen e mjedisit në mënyrë që të jenë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, në pajtueshmëri me ligj, aktet tjera të nxjerra në pajtim me ligjin dhe më këtë rregullore;
- 5.5 Hartimin e masave që kanë për qëllim kontrollin e nivelit të zhurmës në territorin e komunës;
- 5.6 Mbajtjen e shënimeve të cilat përfshijnë të dhënat për të gjitha aktivitetet, aplikimet për leje mjedisore komunale, licenca dhe autorizime tjera mjedisore;
- 5.7 Sigurimin e qasjes së papenguar në informata mjedisore dhe të mundësojë pjesëmarrjen e publikut;
- 5.8 Çështjet tjera mjedisore që dalin nga ligji dhe dispozitat tjera plotësuese të nxjerra në pajtim me ligjin.
- 5.9 Zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor si dhe zvogëlimin ose ndalimin e atyre aktiviteteve ekonomike dhe aktiviteteve tjera që paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisit;
- 5.10 Mbrojtjen e bilancit të përgjithshëm ekologjik në territorin e komunës;
- 5.11 Shfrytëzimin racional dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe tokës bujqësore;
- 5.12 Mbrojtjen e monumenteve të rralla natyrore dhe
- 5.13 Mbrojtjen dhe rehabilitimin e vlerave të peizazhit natyror.

## Neni 6

### Instrumentet për mbrojtjen e mjedisit

- 6.1 Ligjet e aplikuara në Kosovë për mjedis;
- 6.2 Dokumentet për mbrojtjen e mjedisit;
- 6.3 Instrumentet ekonomike;
- 6.4 Dokumentet për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- 6.5 Instrumentet për monitorimin e mjedisit;
- 6.6 Menaxhimin e mbrojtjes së mjedisit nga personat juridik ose fizik.

## **Neni 10**

### **Vlerat e mbrojtura të natyrës**

10.1 Vlerat e mbrojtura të natyrës përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjatë, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

10.2 Në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë ekuilibrin natyror, llojullojshmérinë biologjike dhe peisazhere, hidrografinë, gjeomorfologjinë, gjeologjinë, vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave të natyrës.

## **Neni 11**

### **Shfrytëzimi i hapësirës**

11.1 Me planin zhvillimor të komunës dhe planet rregulluese urbane përcaktohen zonat e ndërtimit në lokacionet e caktuara, varësish nga kapaciteti i pranueshëm i ndotjes së mjedisit dhe qëllimeve të ndërtimit brenda vendeve të caktuara në kuadër të këtyre lokacioneve.

11.2. Në zonat e mbrojtura lejohet kryerja e aktiviteteve në mënyrën e përcaktuar me dispozitat e veçanta, në përputhje me natyrën e ngarkesës së mjedisit.

## **Neni 12**

### **Sipërfaqet publike të gjelbëruara**

12.1 Sipërfaqet publike të gjelbëruara në vendbanime dhe në pjesët e përfshira në planet zhvillimore dhe urbane, ndërtohen dhe mirëmbahen në mënyrën e cila mundëson ruajtjen dhe avancimin e vlerave natyrore dhe të krijuara.

12.2 Nëse për shkak të ndërtimit të objektit, dëmtohen sipërfaqja publike e gjelbëruar, ajo duhet të kompensohet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar nga komuna.

## **Neni 13**

### **Mbrojtja e ajrit**

Subjektet të cilat disponojnë me burim të ndotjes së ajrit janë të obliguar që me masa tekniko-teknologjike dhe me masa tjera, të sigurojë që shkarkimet dhe shpërndarjet në ajër të janë në kufijtë e vlerave të përkufizuara dhe përcaktuara me ligj dhe aktet tjera nënligjore, si në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 14**

### **Mbrojtja e ujit**

14.1 Në përputhje me aktet e veçanta normative të qeverisë, dhe mundësitë e komunës që të përballojë këto nivele, do të caktohen nivelet maksimale të lejueshme të shkarkimit dhe shpërndarjes së ndotësve të ujit.

14.2 Duke respektuar standartet dhe rregullat mbi vlerat e përkufizuara të ndotjes së ujit, ndalohet:

### **Neni 18**

#### **Materiet e rrezikshme**

Personi juridik ose fizik i cili administron materiet e rrezikshme ose i cili aplikon teknologjinë e cila është e dëmshme për mjedisin, është i obliguar që të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme të mbrojtjes dhe sigurisë të përcaktuara me ligj për të minimizuar rrezikun për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

### **Neni 19**

#### **Administrimi me mbeturina**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike, Drejtorinë për Kadastër dhe Kompaninë për grumbullim (administrim) të mbeturinave, në përputhje me aktet që nxjerrë Qeveria e Kosovës, do të përcaktojë rregullat e veprimit, do të hartojë planin për menaxhimin e mbeturinave komunale në territorin e komunës. Këto rregulla do të përbajnë kërkesat teknike dhe kriteret për:

- a) Vendndodhjen ose kriimin e një strukture për mbajtjen dhe hedhjen e mbeturinave;
- b) Lokacionin, klasifikimin, vendosjen dhe transportimin e mbeturinave;
- c) Ripërpunimin, shfrytëzimin dhe metodat tjera të ripërdorimit të mbeturinave;
- d) Mbledhjen, shkatërrimin ose trajtimin e mbeturinave ;
- e) Përdorimin e mbeturinave si material për prodhimin e energjisë, materialeve të papërpunuara etj;
- f) Asgjësimin e materialit sanitar me aparaturen speciale te dedikuar per këtë qëllim.

### **III-DOKUMENTET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

#### **Neni 20**

#### **Planifikimi hapësinor**

20.1 Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban, është përgjegjëse që të hartojë:

- planin zhvillimor komunal;
- planin zhvillimor urban;
- planet rregulluese;
- plani lokal për veprim në mjesht.

20.2 Plani zhvillimor komunal, plani zhvillimor urban dhe plani lokal për veprim në mjesht do të:

- a) Përshkruajë masat për mbrojtjen e natyrës, monumentet me vlera të rralla natyrore nën mbrojtje, ujit, tokës, hapësirave të gjelbëruara dhe zonave rekreative,
- b) Definojë rrezikun mjedisor të lokacioneve të ndotura, lokacioneve të rezikuara nga erozioni, nga hedhja e materialeve të papërpunuara dhe të definjojë propozimin e masave për rehabilitimin e lokacioneve të tillë.
- c) Përcaktojë masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjeshtit për hapësirat e dedikuara për eksploatin e resurseve natyrore, respektivisht, ku do të ndërtohen objektet industriale dhe energjetike, objektet për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave,

**Neni 23**  
**Leje mjedisore komunale**

23.1 Për të gjitha llojet e aktiviteteve dhe projekteve të cilat nuk janë të përfshira në nenet 29,30,31 dhe 33 të Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit nr.03/L-25 dhe nenit-11 të nënparagrafit 1.2, të paragraftit-1 të Ligjit për Vlerësimin në Mjedis nr.03/L-24, të cilat mund të shkaktojnë çrregullime në mjedis, lëshohet Leje Mjedisore Komunale që është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje dhe Mjedisit është përgjegjëse për dhënjen e lejes mjedsiore konform dispozitave ligjore, kësaj rregulloreje pas vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe pagesës së obligimeve sipas rregullore për taksat, ngarkesat komunale dhe gjobat.

23.2 Aplikimi për Leje Mjedisore Komunale bëhet gjatë procedurës së marrjes së lejes ndërtimore. Aplikimi përmban raportin e shkurtër për ndikimet e aktiviteteve apo projekteve në mjedis në përpunhje me metodologjinë për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

**Neni 24**  
**Masat e rehabilitimit**

24.1 Kur mund të dëshmohet për neglizhencën, aktet e paramenduara apo shkeljet nga ana e një personi, ndërmarrjeje apo organi publik në territorin e komunës që sjell një dëm apo aksident mjedor, personi, ndërmarrja apo organi publik do të detyrohet ta kthejë pjesën e dëmtuar në gjendje që nuk paraqet rrezik për shëndetin publik apo në gjendjen e përgjithshme regjeneruesve të pjesës së dëmtuar.

24..2 Në rast se një person, ndërmarrje ose organ publik në territorin e komunës merr pjesë në një aktivitet të vazhdueshëm që mund të sjellë dëm ose aksident mjedor, personit, ndërmarrjes apo organit publik do t'i kërkohet të ndërmarrë masa të arsyeshme që të sigurojë se aktivitetet e tillë në të ardhmen të bëhen në mënyrë që të:

- Zvogëlojë shkarkimin dhe shpërndarjen e nivelit gjer në sjelljen e kufijve te lejueshëm;
- Të minimizohet rreziku për një aksident mjedor.

24.3 Nëse pala përgjegjëse për dëmin mjedor nuk mund të vërtetohet ose në rastet kur personi apo ndërmarrja nuk kanë fonde të mjaftueshëm të rregullojnë dëmin mjedor, komuna, në rast se dëmi paraqet rrezik të vazhdueshëm për shëndetin publik, duhet të hartojë dhe të implementojë një program të arsyeshëm për rregullimin e dëmit.

24.4 Në rastet kur, identiteti i palës zbulohet, komuna do t'i paguhen mjetet e shpenzuara për rehabilitimin e dëmit.

28.2 Policia dhe zyrtarë tjerë publik të autorizuar, të cilët gjatë kohës së kryerjes së detyrës së tyre vijnë në dijeni lidhur me aksidentet ekologjike ose çrregullime tjera mjedisore në territorin e komunës, do të njoftojnë menjëherë institucionet e lartcekura në nenin 13.1 dhe 29.1 si dhe te marrin masa parandaluese

28.3 Komuna do të bashkëpunojë me MMPH në gjetjen e shkaqeve të çrregullimeve mjedisore dhe të përgjegjësit për çrregullime.

### Neni 29

#### Shpallja e gjendjes së rrezikshmërisë

Në rast të aksidentit mjedor, varësisht nga përmasat, brenda ose jashtë pajisjeve dhe vlerësimit të pasojave të cilat mund të shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, në bazë të raportit dhe rekomandimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kryetari i Komunës shpall gjendjen emergjente për mjedisin të rrezikuar dhe për këtë njofton publikun, si dhe kuvendin e komunës për masat e marra.

### VII-KONTROLLI DHE INFORMIMI PËR NDOTJE TË MJEDISIT

#### Neni 30

##### Monitorimi

30.1 Komuna në kuadër të përgjegjësive të veta të përcaktuara me ligj siguron kontrollin e vazhdueshëm dhe bënë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me ligj, ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit.

30.2 Personat juridik ose fizik të cilët me veprimtarinë ose me aktivitetin e tyre e ndotin mjedisin, në kuadër të përgjegjësive të veta të përcaktuara me ligjin, sigurojnë kontrollin e vazhdueshëm dhe bëjnë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me këtë ligj si dhe ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit.

### Neni 31

#### Të dhënat përmbrrojtjen e mjedisit

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, mbanë të dhëna të cilat nuk janë pjesë e Sistemit Informativ përmbrrojtjen e Mjedisit, e të cilat përfshijnë pa kufizim:

- Të gjitha subjektet që ndërmarrin veprimtari të autorizuara dhe veprimtaritë e tyre;
- Kërkesat përmbrrojtjen, licencat dhe autorizimet të tjera të tillë, që kërkohen e jepen dhe çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me to;
- Çfarëdo informacioni tjetër të marrë ose të siguruar sipas dispozitave të Ligjit përmbrrojtjen e Mjedisit apo akteve tjera normative;
- Hollësi përmbrrojtjen e vendosura sipas ligjit dhe akteve tjera normative.

## **X-FINANCIMI I MBROJTJES SË MJEDISIT**

### **Neni 36**

Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në kuadër të buxhetit, sigurojnë financimin dhe realizimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit.

### **Neni 37**

#### **Kompensimet që i cakton komuna**

37.1 Komuna me propozim të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe në bashkëpunim me institucionet relevante – qeveritë – MMPH do të përcaktojë kompensimin për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit për çdo person juridik ose fizik që me veprimtarinë ose me aktivitetin e vet ndot ose mund të ndotë mjedisin.

37.2 Për caktimin e lartësisë për kompensimin nga paragrafi 1 i këtij nenit, mënyrën e pagesës, si dhe lehtësimet për çdo person juridik ose fizik që me veprimtarinë ose me aktivitetin e vet ndot ose mund të ndotë mjedisin, do të rregullohen sipas rregullores komunale për ngarkesa dhe tarifa.

### **Neni 38**

#### **Shpërblimet për ambientin më të pastër**

Komuna mund të ndaj shpërblime për ambientin më të pastër në territorin e komunës (Lagja, fshati, shkolla etj.). Data dhe forma apo lartësia e shpërbimit që do të ndahet, do të caktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

## **XI. MBIKËQYRJA INSPEKTUESE**

### **Neni 39**

39.1 Mbikëqyrjen inspektuese të zbatimit të masave për mbrojtjen e mjedisit dhe mbikëqyrjen e çrrëgullimeve mjedisore në territorin e komunës, ndikimi i të cilave nuk i kalon kufijtë e komunës dhe të cilat mund të zgjidhen, kontrollohen dhe parandalohen nga organet komunale, e bën inspektori për mjedis.

39.2 Punët e inspektorit mund t'i kryejë edhe zyrtari tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon komuna.

39.3 Personat juridik ose fizik, veprimtaritë dhe aktivitetet e të cilëve i nënshtronen mbikëqyrjes, janë të detyruar që inspektorit t'i mundësojnë zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, t'i ofrojnë dokumentacionin dhe të gjitha të dhënat e nevojshme.

### **Neni 40**

40.1 Gjatë inspektimit të veprimtarive dhe aktiviteteve të personave juridik ose fizik, inspektori kërkon nga personi përgjegjës që:

40.1.1 T'i mundësojë kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në të gjitha lokalet e punës,

stabilimentet dhe pajisjet dhe në ambientet e hapura të personit të mbikëqyrur;

40.1.2 Të ofrojë të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për mbikëqyrje inspektuese;

43.1.3 Të ndalojë kryerjen e aktivitetit në procesin e prodhimit, përdorimin e stabilimenteve, mjeteve dhe pajisjeve nga të cilat ka ardhur ose mund të vijë deri te një ndotje më e madhe e mjedisit, derisa të metat dhe parregullsitë në punë të mos eliminohen;

43.1.4 Të ndalojë punimet nëse ato kryhen në kundërshtim me masat e përcaktuara për vlerësimin e ndikimit në mjedis deri sa parregullsitë të mënjanohen;

43.1.5 Të ndërpres punimet nëse ato nuk kryhen në pajtueshmëri me kushtet e dhëna;

43.1.6 Të ndalojë punët për të cilat ai nuk është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë profesionale për mbrojtjen e mjedisit.

43.2 Nëse personi juridik ose fizik nuk zbaton masat nga nën-paragrafi 1.1 paragrafi 1. i këtij neni, inspektori në afat të arsyeshëm të ndërmerr masa përmes personave të tjerë në shpenzime të shkaktuesit të dëmit.

43.3 Për faktet e verifikuara në procedurën e inspektimit, gjegjësisht për masat e ndërmarra, inspektori është i detyruar ta njoftojë personin i cili ka bërë shkelje ne kundërshtim me Rregulloren.

43.4 Me qëllim të sigurimit të zbatimit të ndalesave dhe shkeljeve të përcaktuara me dispozita të tjera, inspektori për mbrojtjen e mjedisit ka të drejtë dhe obligim që:

43.4.1 Pa vonesë të parashtrojë fletëparaqitje organit kompetent për veprën e dënueshme;

43.4.2 T'i propozojë organit kompetent fshirjen nga regjistri i veprimtarisë për të cilën vërtetohet se personi nuk i plotëson kushtet e parapara me ligj;

43.4.3 Të ndërmerr masa të tjera për të cilat është i autorizuar.

#### Neni 44

##### Detyrimet e inspektorëve për bashkëveprim

Në rastet kur inspektori në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese vlerëson se përvëç shkeljes së dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij, janë shkelur edhe dispozitat e ligjeve tjera me rëndësi për mbrojtjen e mjedisit, është i detyruar që krahas marrjes së masave për të cilat është i autorizuar, të njoftojë edhe organin tjetër kompetent në mënyrë që bashkërisht të kryejnë mbikëqyrjen inspektuese dhe të ndërmarrin masat e parapara me ligj.

#### Neni 45

##### Procedura e ankesës

45.1 Në procedurën e ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese, në rastet e marrjes së masave për urdhëresa dhe ndalesa, inspektori i mjedisit nxjerrë vendim.

45.2 Në ankesën kundër vendimit të organit kompetent komunal vendos Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

45.3 Për rastet e eliminimit të rrezikut të drejtpërdrejtë për mjedisin, jetën dhe shëndetin e njeriut ankesa e ushtruar kundër vendimit të inspektorit, nuk e shtyn ekzekutimin.

- 49.2.3 Hedh ambalazhë dhe mbeturina qelqi në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 49.2.4 Hedh kanaçe në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 49.2.5 Hedh mbeturina ushqimore në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 49.2.6 Si kalimtar rasti hedh çfarëdo lloj mbeturine në rrugë ose në sipërfaqe publike.

**49.3 Me gjobë në vlerë prej 20 euro i shqiptohet dënimini personit nëse:**

- 49.3.1 Hedh mbeturina komunale jashtë kontejnerit;
- 49.3.2 Hulumton nëpër kontejner të mbeturinave, merr ose shkapërderdh-hedh mbeturina prej kontejnerit jashtë;
- 49.3.3 Hedh mbeturina të përziera te kontejnerët ku janë të klasifikuara mbeturinat si organike, qelqi, letra, plastika, metali etj;
- 49.3.4 Mbeturinat nga copëtimi i drunjve i lë në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 49.3.5 Mbeturinat nga thëngjilli i lë në rrugë ose në sipërfaqe publike,
- 49.3.6 Nuk pastron jashtëqitjen e kafshës së tij në rrugë, trotuare, parkingje, objekte të banimit kolektiv dhe objekte tjera publike.

**49.4 Me gjobë në vlerë prej 30 euro i shqiptohet dënimini personit nëse:**

- 49.4.1 Hedh cigare në rrugë nga automjeti,
- 49.4.2 Hedh ambalazhë dhe mbeturina letre në rrugë nga automjeti,
- 49.4.3 Hedh ambalazhë dhe mbeturina plastike në rrugë nga automjeti,
- 49.4.4 Hedh ambalazhë dhe mbeturinë qelqi në rrugë nga automjeti,
- 49.4.5 Hedh kanaçe në rrugë nga automjeti,
- 49.4.6 Hedh mbeturina ushqimore në rrugë nga automjeti,
- 49.4.7 Dëmton kontejnerët për mbeturina,
- 49.4.8 Ndërron vendin kontejnerëve për mbeturina,
- 49.4.9 Hedh akumulatorë në kontejnerët për mbeturina,
- 49.4.10 Hedh pajisje elektrike dhe elektronike në kontejnerët për mbeturina,
- 49.4.11 Hedh mbeturina të automjeteve të vjetra në kontejnerët për mbeturina,
- 49.4.12 Hedh ambalazhë dhe mbeturina letre ne natyrë,
- 49.4.13 Hedh ambalazhë dhe mbeturina plastike në natyrë,
- 49.4.14 Hedh ambalazhë dhe mbeturina qelqi në natyrë,
- 49.4.15 Hedh kanaçe në natyrë,
- 49.4.16 Hedh mbeturina ushqimore në natyrë,
- 49.4.17 Hedh mbeturina nga kopshtet në kontejnerët për mbeturina.

**49.5 Me gjobë në vlerë prej 50 euro i shqiptohet dënimini personit nëse:**

- 49.5.1 Hedh çfarëdo lloj mbeturine nga ballkoni ose dritarja e objektit,
- 49.5.2 Hedh mbeturina në pusetat për kanalizim,
- 49.5.3 Hedh mbeturina nga ambalazha e materialit ndërtimor jashtë kontejnerit,
- 49.5.4 Hedh mbeturina të ngjyrave në kanalizim,
- 49.5.5 Hedh mbeturina të ngjyrave në kontejner për mbeturina,
- 49.5.6 Hedh mbeturina të vajit në tokë nga pakujdesia,
- 49.5.7 Hedh mbeturina medicinale në kontejner për mbeturina,
- 49.5.8 Hedh mbeturina të stallave në afërsi të rrugës brenda vendbanimit (nuk

#### **XIV-DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

##### **Neni 50**

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje janë përgjegjës: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Inspektim, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Policia e Kosovës, KRM "Uniteti" dhe Gjykata Komunale për Kundërvajtje.

##### **Neni 51**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen nenet 37, 38, 39, 40, 42, 43, 163, 164, 165, 166, 167 dhe 168 të Rregullores mbi Shërbimet Komunale dhe rregullimin e qytetit nr. 731, të dt 29.09 2004

##### **Neni 52**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

